REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 1123/20
Datum. 12.01.21
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.1123/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "N.N.SH. Vizion Projekt – Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mbikëqyrja e objektit te ri Administrativ dhe objekteve përcjellëse te N.P Termokos SH.A", me numër të E-prokurimit: NP Termokos sha 020-4865-2-2-1, të iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) –N.P Termokos Sh.A, më datën: 11.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "N.N.SH. Vizion Projekt – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mbikëqyrja e objektit te ri Administrativ dhe objekteve përcjellëse te N.P Termokos SH.A", me numër të E-prokurimit: NP Termokos sha 020-4865-2-2-1, të iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) –N.P Termokos Sh.A.

II. **ANULOHET**, njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mbikëqyrja e objektit te ri Administrativ dhe objekteve përcjellëse te N.P Termokos SH.A", me numër të E-prokurimit: NP Termokos sha 020-4865-2-2-1, të iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) –N.P Termokos Sh.A, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e Operatorit Ekonomik ankues "N.N.SH. Vizion Projekt – Prishtinë,, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik "N.N.SH. Vizion Projekt – Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 21.12.2020 me nr. 1123/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mbikëqyrja e objektit te ri Administrativ dhe objekteve përcjellëse te N.P Termokos SH.A", me numër të E-prokurimit: NP Termokos sha 020-4865-2-2-1, të iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) –N.P "Termokos" Sh.A, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 59, 65 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe 39.8 te RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.12.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 29.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:
Duke u mbështetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:
Përgjigje në Pretendimi nr.1
Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 7 dhe 59 të LPP-së, me rastin eliminimit të kompanisë tonë me arsyetimin të pabazuara dhe të paqëndrueshme se kinse nuk i plotësojmë "kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional respektivisht kërkesës qe ndërlidhën me dëshmitë e stafit, inxhinierit të energjisë efiçencës, ekspertit të licencuar për mbrojtje kundër zjarrit dhe ekspertit te licencuar për ndikim ne mjedis"

Duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se AK ka eliminuar operatorin ekonomik ankues me arsyetimin se:

"1.Sipas komisionit të Vlersimit te tenderve pika .III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: INXHINIER I ENERGJISE SË EFIÇENCËS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1 nuk keni plotsuar kete kerese te Dosjes se Tenderit stafi i prenzantuar nga ana juaj nuk plotesone kerkesen , qe ka qene kriter ne Njoftim per kontrat dhe ne DT.

2. Sipas komisionit te Vlersimit te tenderve pika .III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: EKSPERT I LICENSUAR DHE ME CERTIFIKATË PËR MBROJTJE KUNDËR ZJARRI ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1 nuk keni plotsuar kete kerese te Dosjes se Tenderit stafi i prenzantuar nga ana juaj nuk plotesone kerkesen , qe ka qene kriter ne Njoftim per kontrat dhe ne DT.

3. Sipas komisionit te Vlersimit te tenderve pika .III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: EKSPERT I LICENSUAR DHE ME CERTIFIKATË PËR NDIKIMIN NË MJEDIS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1 nuk keni plotsuar kete kerese te Dosjes se Tenderit stafi i prenzantuar nga ana juaj nuk plotesone kerkesen , qe ka qene kriter ne Njoftim per kontrat dhe ne DT."

Ndërsa AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit lidhur me stafin e lartë cekur ka parashtruar kërkesat dhe dështimë si vijon:

Kërkesat:

Kërkesa 8: INXHINIER I ENERGJISE SË EFIÇENCËS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1

Kërkesa 9: EKSPERT I LICENSUAR DHE ME CERTIFIKATË PËR MBROJTJE KUNDËR ZJARRI ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT-1

Kërkesa 10: EKSPERT I LICENSUAR DHE ME CERTIFIKATË PËR NDIKIMIN NË MJEDIS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1

Dështmit e kërkuara:

Dështmia 8: INXHINIER I ENERGJISE SË EFIÇENCËS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1 TE PREZANTOHET DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR DHE DESHMI PER PRVOJEN E PUNES NGA TRUSTI PENSIONAL **OSE DESHMI TJERA**

Dështmia 9: EKSPERT I LICENSUAR DHE ME CERTIFIKATË PËR MBROJTJE KUNDËR ZJARRI ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1 TE PREZANTOHET DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR DHE DESHMI PER PRVOJEN E PUNES NGA TRUSTI PENSIONAL **OSE DESHMI TJERA**

Dëshmia 10: EKSPERT I LICENSUAR DHE ME CERTIFIKATË PËR NDIKIMIN NË MJEDIS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1 TE PREZANTOHET DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR DHE DESHMI PER PRVOJEN E PUNES NGA TRUSTI PENSIONAL **OSE DESHMI TJERA**.

Ndërsa OE ankues së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar listën me të dhënat e stafit, në këtë listë përveç të dhënave të stafit tjetër:

1. Nën numrin rendor 12 ka paraqitur z.Avni Sfishta ne cilësin e inxhinierit të diplomuar te Makinerisë-Auditor i energjisë, ekspertë i efiçiencës së energjisë, si dhe ka bashkangjitur kopjen e kontrates se bashkpunimit, CV, kopjen e diplomes te vertetuar tek noteri- te leshuar në vitin 2005, me te cilen deshmohet se i njejti ka mbaruar studimet për inxhinier i diplomuar i Makinerisë, Certifikatat e lëshuara nga organizata ''Giz'' në vitet 2017 dhe 2018, certificate trajnimi e leshuar nga organizata ''bre'', leter referencat te leshuara nga organizata "Kosep", leter referencen e lëshuar nga "Nalas", leter referencen e lëshuar nga organizata "Aecom" , leter referencen e lëshuar nga organizata "giz" leter referencen e lëshuar nga organizata "ËYG international Limited" , leter referencen e lëshuar nga organizata "UN", leter referencen e lëshuar nga organizata "Drejtoria e buregjeve Prishtinë",, leter rekomandim te leshuar nga "gtz" , certifikatat e trajnimit të lëshuar nga organizata "AUK", certifikaten e leshuar nga Ministria e Energjisë dhe Minierave, certifikaten e leshuar nga kompania "FLIR", certifikaten e leshuar nga nga kompania ''Inëent" , certifikaten e leshuar nga kompania "denk model" , certifikaten e leshuar nga kompania "DNV"dhe certifikaten e leshuar nga kompania "TURKheinland".
2. Nën numrin rendor 13 ka paraqitur z. Adem Ramadani ne cilesin e ekspetit të licencuar dhe me certifikate për mbrojtje kundër zjarrit, dhe për të njejtin ka bashkangjitur kopjen e kontrates së bashkpunimit, kopjen e diplomes Master i Menagjmentit të Emergjencave te vertetuar tek noteri- te leshuar në vitin 2015, me të cilen dëshmohet se i njejti ka mbaruar studimet me 22.04.2015, certifikaten për provimin professional në lemin e mbrojtjes nga zjarri te leshuara nga MPB, kopjen e references të lëshuar nga "NNSH Vizion Project".
3. Nën numrin rendor 14 ka paraqitur z. Islam Fejza ne cilësin e ekspetit të licencuar dhe me certifikate për ndikim në mjedis, dhe për të njejtin ka bashkangjitur kopjen e kontrates së bashkpunimit, Cv, kopjen e diplomes Doktor i Shkencave teknike te vertetuar tek noteri- te leshuar në vitin 2007, me të cilen dëshmohet se i njejti ka mbaruar studimet me 11.05.2007, kopjen e licencës nr.5/19 për hartimin e raporteve VNM-së të leshuara nga MMPH-së e vertetuar tek noteri, kopjen e references të lëshuar nga "NNSH Vizion Project".

Bazuar në faktet e lartë cekura eksperti shqyrtues konstaton se AK me rastin e rivlerësimit të ofertave nuk e ka zbatuar në tërësi rekomandimin e dalur me vendimin e OSHP-së PSH 803,820 te dates 13.11.2020 që të zbatoj nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave sepse OE ankuese së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar dëshmi të mjaftushme konform kërkesave të parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit lidhur me inxhinierin e energjis efiqiente, ekspetin e licencuar dhe me certifikate për mbrojtje kundër zjarrit si dhe ekspertin e licencuar për ndikim në mjedis. Nese AK i ka pas të paqarta dëshmit e dorëzuar nga OE ankues, atëherë ka qenë dashur që të marr për bazë rekomandimin e dalur me vendimin e OSHP-së PSH 803, 820 te dates 13.11.2020 që të zbatoj nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave dhe të kërkoj sqarime para se të marr vendim që ta eliminoj. Andaj pretendimi i lartë cekur i OE ankues **është i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimet e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 65 dhe 69 të LPP-së, duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues **nuk janë të bazuara** sepse OE ankuese pretendimet ne fjale vetëm i ka cekur sipërfaqësisht pa sqaruar dhe pa dhenë ndonjë fakt rreth shkeljes se këtyre neneve në deklaratën e ankesës se dorëzuar, po ashtu me nenin 65 dhe 69 të LPP-së rregullohen respektivisht udhëzohen autoritetet kontraktuese se në cilat raste nuk mund të bëhet pranushmeria e kandidatëve respektivisht i ndalohet tenderuesve që të marrin pjesë në një aktivitet të prokurimit si dhe udhëzohen autoritetet kontraktues se si mund të kërkojnë dhe vendosin në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontratë kërkesat minimale si dhe cilat dëshmi duhet të kërkohen-dorëzohen nga OE lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, gjatë ushtrimit/zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues **"N.N.SH. Vizion Projekt** – Prishtine, **të aprovohet si pjesërisht e bazuar**, ndërsa të anulohet vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit te prokurimit si dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

Autoriteti kontraktues me datë 05.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik me datë 30.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "N.N.SH. Vizion Projekt – Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 7 dhe 59 të LPP-së me rastin eliminimit të kompanisë tonë me arsyetimin të pabazuara dhe të paqëndrueshme se kinse nuk i plotësojmë "kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional respektivisht kërkesës qe ndërlidhën me dëshmitë e stafit, inxhinierit të energjisë efiçencës, ekspertit të licencuar për mbrojtje kundër zjarrit dhe ekspertit te licencuar për ndikim ne mjedis".

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, tenderit të OE ankues, arsyeve të eliminimit sipas raportit të vlerësimit, kërkesës së AK-së, si dhe sqarimit të ekspertit shqyrtues, konstaton se OE ankues së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar listën me të dhënat e stafit, ku në këtë listë përveç të dhënave të stafit tjetër:

1. Në numrin rendor 12 ka paraqitur z. Avni Sfishta nës cilësinë e inxhinierit të diplomuar të Makinerisë-Auditor i energjisë, ekspert i efiçiencës së energjisë, si dhe ka bashkangjitur kopjen e kontratës së bashkëpunimit, CV, kopjen e diplomës të vërtetuar tek noteri- të lëshuar në vitin 2005, me te cilën dëshmohet se i njëjti ka përfunduar studimet për inxhinier i diplomuar i Makinerisë, Certifikatat e lëshuara nga organizata "Giz" në vitet 2017 dhe 2018, certifikatë trajnimi e lëshuar nga organizata "bre", letër referencat të lëshuara nga organizata "Kosep", letër referencën e lëshuar nga "Nalas", letër referencën e lëshuar nga organizata "Aecom", letër referencën e lëshuar nga organizata "giz", letër referencën e lëshuar nga organizata "ËYG international Limited", letër referencën e lëshuar nga organizata "UN", letër referencën e lëshuar nga organizata "Drejtoria e buregjeve Prishtinë", letër rekomandim të leshuar nga "gtz", certifikatat e trajnimit të lëshuar nga organizata "AUK", certifikatën e lëshuar nga Ministria e Energjisë dhe Minierave, certifikatën e lëshuar nga kompania "FLIR", certifikatën e lëshuar nga kompania "Inëent", certifikatën e lëshuar nga kompania "denk model", certifikatën e lëshuar nga kompania "DNV" dhe certifikatën e lëshuar nga kompania "TURK heinland".
2. Nën numrin rendor 13 ka paraqitur z. Adem Ramadani në cilësinë e ekspertit të licencuar dhe me certifikatë për mbrojtje kundër zjarrit, dhe për të njëjtin ka bashkangjitur kopjen e kontratës së bashkëpunimit, kopjen e diplomës Master i Menaxhmentit të Emergjencave të vërtetuar tek noteri-

të lëshuar në vitin 2015, me të cilën dëshmohet se i njëjti ka përfunduar studimet me 22.04.2015, certifikatën për provimin profesional në lëmin e mbrojtjes nga zjarri të lëshuara nga MPB, kopjen e referencës të lëshuar nga "NNSH Vizion Project".

3. Nën numrin rendor 14 ka paraqitur z. Islam Fejza në cilësinë e ekspertit të licencuar dhe me certifikatë për ndikim në mjedis, dhe për të njëjtin ka bashkangjitur kopjen e kontratës së bashkëpunimit, Cv, kopjen e diplomës Doktor i Shkencave teknike të vërtetuar tek noteri- të lëshuar në vitin 2007, me të cilën dëshmohet se i njëjti ka përfunduar studimet me 11.05.2007, kopjen e licencës nr.5/19 për hartimin e raporteve VNM-së të lëshuara nga MMPH-së e vërtetuar tek noteri, kopjen e referencës të lëshuar nga "NNSH Vizion Project".

Duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se AK me rastin e rivlerësimit të ofertave nuk e ka zbatuar në tërësi rekomandimin sipas vendimit të OSHP-së PSH.nr.803-820/20 të datës 13.11.2020, ku AK është obliguar që të zbatoj nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave sepse OE ankuese së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme konform kërkesave të parashtruara nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit lidhur me inxhinierin e energjisë efiçiente, ekspetin e licencuar dhe me certifikate për mbrojtje kundër zjarrit, si dhe ekspertin e licencuar për ndikim në mjedis. Nëse AK i ka pas të paqarta dëshmitë e dorëzuara nga OE ankues, atëherë ka qenë dashur që të marr për bazë rekomandimin sipas vendimit të OSHP-së PSH.nr.803-820/20 të datës 13.11.2020 që të zbatoj nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, si dhe të kërkoj sqarime para se të marr vendim që ta eliminoj. Andaj pretendimi i lartë cekur i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 65 dhe 69 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim është i pa bazuar sepse OE ankues pretendimet në fjalë vetëm i ka cekur sipërfaqësisht pa sqaruar dhe pa dhënë ndonjë fakt rreth shkeljes së këtyre neneve në deklaratën e ankesës së dorëzuar. Po ashtu me nenin 65 dhe 69 të LPP-së rregullohen respektivisht udhëzohen autoritetet kontraktuese se në cilat raste nuk mund të bëhet pranueshmëria e kandidatëve, respektivisht i ndalohet tenderuesve që të marrin pjesë në një aktivitet të prokurimit si dhe udhëzohen autoritetet kontraktues se si mund të kërkojnë dhe vendosin në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë kërkesat minimale, si dhe cilat dëshmi duhet të kërkohen-dorëzohen nga OE lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, gjatë ushtrimit/zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues e ka eliminuar operatorin ekonomik pa të drejtë edhe pse i njëjti i plotëson kërkesat e AK-së, dhe

me këtë rast e ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues ka vërejtur se AK gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka përfillur udhëzimet e Panelit Shqyrtues, respektivisht vendimin PSH.nr.803-820/20 të datës 13.11.2020.

Andaj, obligohet autoriteti kontraktues që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve duke u bazuar ne kërkesat e dosjes së tenderit të cilat i ka vetë i ka vendosur, njëherit të bëje vlerësimin në harmoni me nenin 59 të LPP-së, si dhe të zbatoj vendimet e Panelit Shqyrtues. Në të kundërtën, AK dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit e detyron Panelin Shqyrtues që të ndërmerr masa konform dispozitave ligjore për mos zbatim të vendimeve të Panelit Shqyrtues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "N.P Termokos Sh.A";

1x1 OE N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.